

pasqyra e lajmeve, KIC, 10.09.1998, FDH-29556.

### Himë (Athem) Krasniqi

(1936, shqiptar nga Pastasella/Pusto Selo, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, pesë fëmijë)

### Ismet (Himë) Krasniqi

(1957, shqiptar nga Pastasella/Pusto Selo, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Himë Krasniqi me të birin Ismetin dhe familjarë të tjerë e braktisën fshatin Pastasellë/Pusto Selo në fund të muajit gusht të vitit 1998. U strehuan në pyll, në vendin e quajtur *Lugu i Pipave/Dolina pupoljaka*. Në mbremjen e datës **3.09.1998**, ata që të dy u kthyen në **Pastasellë/Pusto Selo** për ta lëshuar bagëtinë në kullotë. Nuk u kthyen më te familjarët në pyll. Në datën 5.9.1998, familjarët i kanë gjetur trupat e Himës dhe të Ismetit në bunar, i cili gjendet në oborrin e familjes Krasniqi. Ishin të lidhur me tel dhe nëpër trup i kishin gjurmët e torturimit. Po atë ditë, familjarët i kanë varrosur Himën dhe Ismetin në varrezat në Pastasellë/Pusto Selo.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-17946; J. Martinsen, *DodsbrÖnnene...*, 50; *Bodies of Killed Albanians Scattered about in Rahovec Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 10.09.1998, FDH-29556.

### Zenun (Ibrahim) Morina

(5.07.1923, shqiptar nga Sapniqi/Sopnić, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Zenuni i moshëthyer jetonte me familjen e të birit Elhamiut. Në mëngjesin e datës **3.09.1998**, forcat serbe e bombarduan Sapniqin/Sopnić, e më pas, pjesëtarë të forcave serbe hyrën në fshat. Popullata u arratis nga shtëpitë e veta. Por, Zenuni ndenji në shtëpinë e vet. Më vonë, kur situata u qetësua pakëz, Elhamiu u kthye në fshat, e mori të atin dhe e çoi te vendi i quajtur *Lipoçe*, ku gjendej vëllai i Zenunit, Bajrami. Pas pak, Zenuni, nga vendi ku ishte, vërejt se një predhë e kishte shkaktuar zjarrin në ahurin e tij. Vrapoi me ngut për ta shukur zjarrin [**Sapniq/Sopnić**]. Nuk u kthye më. Kur bombardimi pushoi, vëllai i Zenunit,

Isufi, e ka gjetur trupin e djegur të Zenunit. Ishte në oborr afër ahurit. Pranë kufomës gjendeshin drunjtë djegëse dhe një gastare e zbrazët me tretës. Isufi e varrosi Zenunin në tokën në pronësi familjare. Dy muaj më vonë, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Zenunit në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata M.B, FDH-15502; *Seb Forces Continue Destroying. Torching Albanian Settlement in Rahovec Municipality*, pasqyra e lajmeve, KIC, 5.09.1998, FDH-29551.

### Xhafer (Hamëz) Vehapi

(3.06.1975, shqiptar nga Zatriqi/Zatrić, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

### Esat (Rrahim) Kastrati

(16.10.1978, shqiptar nga Zatriqi/Zatrić, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

### Mazllum (Alush) Kastrati

(6.09.1979, shqiptar nga Zatriqi/Zatrić, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Xhaferi, Esati dhe Mazllumi aderuan në radhët e UÇK-së më 28.04.1998, kur u themelua shtabi lokal në Zatriq/Zatrić. Në ndërkohë, pjesëtarë të forcave serbe e kanë rritur pranin e tyre përreth fshatit. Fëmijët hoqën dorë nga shkuarja në shkollë, ndërkaq burrat e fshatit filluan të mbanin rojën e përhershme rreth Zatriqit/Zatrić.

Në datën 2.09.1998, Esati dhe Mazllumi gjendeshin te pozicionet e veta në hyrje të fshatit, pranë rrugës së asfaltuar, në vendin e quajtur *Akavan*. Xhaferi gjendej te pozicioni i vet te antena telefonike, në një bleshkë të afërt. Sulmi i UJ-së ka filluar më **3.09.1998**, rreth orës 8:30, së pari me anë të avionëve që kaluan mbi fshatin dhe e bombarduan atë. Nga ora 11:00, pjesëtarë të policisë serbe filluan tu afroreshin pozicioneve të UÇK-së. Esati dhe Mazllumi e morën urdhrin që t'i lëshonin pozicionet e veta dhe tu dalin në ndihmë civilëve që filluan ta braktisnin fshatin [**Zatriq/Zatrić**]. Të shtënat kanë pushuar rreth orës 18:00. Xhaferi me ushtarë të tjerë të UÇK-së shkuan në fshat për të ngrënë darkën. Mendonin se Esati dhe Mazllumi e kishin braktisur fshatin, së bashku me familje të